



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 12.07.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN E KONEKTIVITETIT TË RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE””

1.0 Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 12.07.2018 shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin Z. Erjon Luçi, Zëvendësministër në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Znj. Luljeta Dauti, Specialiste në MFE, Z. Tedi Bushaj, Specialist në MFE, Znj. Brikena Jazxhi, Specialiste në MFE, Z. Ermir Omari, Projekt menaxher pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit

2.0 Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

3.0 Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

4.0 Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji që paraqitet për ratifikim ka si qëllim, ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale, nëpërmjet akordimit të një huaje në shumën 50 milionë USD.

Nevoja për akordimin e këtij financimi, lind referuar problematikave infrastrukturore dhe nevojës për përmirësim në rrugët lidhëse rajonale, potencialit turistik që kanë zonat e projektit, si dhe vlerësimit të prioritetëve të qeverisë shqiptare me fokus zhvillimin e infrastrukturës.

Ky projekt parashikohet të sjellë efektet e mëposhtme:

1. Rehabilitimi i rrugëve rajonale dhe lokale, duke ofruar një lidhje më të mirë dhe më të sigurt me rajonet e përfshira ku jetojnë e punojnë rreth 80 000 (tetëdhjetë mijë) banorë.
2. Përmirësimi i klimës së qëndrueshmërisë në rrjetin rrugor.
3. Forcimi i kapaciteteve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe bashkive të këtyre rajoneve për të menaxhuar projektet e ndërtimit të aseteve rrugore, në drejtim të një prioritizimi më të mirë të investimeve dhe aktiviteteve të mirëmbajtjes.

Zbatimi i projektit është i ndarë në 3 komponentë:

- *Përmirësimi i aksesueshmërisë.*

Këtu përfshihen:

- a) punimet për rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe rurale në bashkitë e përzgjedhura;
- b) iniciativat e lidhura me sigurinë rrugore, përfshirë gjurmët e këmbësorëve, korsitë e dedikuara për biçikletat, përmirësimet e sigurisë, shenjat e orientimit.

- *Ngritja e kapaciteteve për bashkitë.*

Këtu përfshihen:

- a) ngritja e kapaciteteve të bashkive për të menaxhuar dhe mirëmbajtur rrjetet rrugore në drejtim të:
 - i. ofrimit i këshillave për të përmirësuar sistemet ekzistuese të menaxhimit të aseteve, për të përmirësuar planifikimin dhe prioritizimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes dhe rehabilitimit;
 - ii. zhvillimit të një marrëveshjeje standarde të nivelit të shërbimit për të përmirësuar efikasitetin e ekzekutimit të mirëmbajtjes; dhe
 - iii. kryerjes së aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve për komunat e përzgjedhura për të zbatuar në mënyrë efektive programet e mirëmbajtjes së rrugëve;
- b) mbështetja e bashkive të përzgjedhura për implementimin e programeve të zhvillimit rural, përfshirë dhënien e këshillave për vlerësimin e potencialit të tregut në nivel fshati.

- *Mbështetja e menaxhimit të implementimit.*

Kjo pjesë parashikon dhënien e mbështetjes për menaxhimin e projektit ku përfshihen mes të tjerave zhvillimi dhe mbajtja e një sistemi të informacionit gjeografik (GIS), përdorimi i një databaze për prioritizimin e rrugëve rajonale dhe rurale.

Afati i fundit për tërheqjen e fondeve në kuadër të kësaj marrëveshjeje huaje është data 31 dhjetor 2022.

Huaja ka një afat maturimi prej 29.5 vitesh, duke përfshirë periudhën prej 6 vitesh pa pagesë principali. Projekti është pjesë e parashikimeve të programit buxhetor afatmesëm 2018 – 2020 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj marrëveshjeje huaje janë Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në cilësinë e Njesisë së Zbatimit të Projektit dhe ministria përgjegjëse për financat dhe ekonominë.

Marrëveshja e huas është miratuar, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.172, datë 28.3.2018, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve.

5.0. Efektet financiare :

Huaja që akordohet nëpërmjet kësaj marrëveshjeje është në shuma 50 000 000 USD, me maturimi 29.5 vjet, duke përfshirë periudhën prej 6 vitesh pa pagesë principali.

6.0. Diskutimet në Komision

Deputetet në diskutimet e tyre vlerësuan rëndësinë e projektligjit dhe sugjeruan që projekte të kësaj natyre duhet të merren pasi të janë evidentuar zonat me probleme , sqarim u kërkuar edhe për parashikimin në marrëveshje si zë, rritja e kapaciteteve të FSHZH, kur dihet se ky fond ka kohë që e ushtron veprimtarinë e tij. Gjithashtu deputetet pyeten se cilat janë bashkitë që përfitojnë nga marrëveshja dhe cilat janë kriteret për përzgjedhjen e tyre, në se është bërë paraprakisht studimi i fizibilitetit.

Në përgjigje të pyetjeve të deputeteve përfaqësuesit e ministrave dhanë sqarime dhe informacion më të zgjeruar si për natyrën e projekteve , bashkitë ku do të zbatohen ato, si dhe kriteret e përzgjedhjes.

7.0 Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, i cili është organi kompetent sipas përcaktimeve që i bën neni 81 i Kushtetutës së Shqipërisë. Projektligji shoqërohet dhe me relacionin përkatës sipas nenin 68 të Rregullores së Kuvendit.

Procedura e ndjekur për hartimin e nënshkrimit të marrëveshjes “*Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale*” është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 “Për Marrëveshje ndërkombëtare.” në të cilën thuhet “

1. Ratifikimi është akti, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar më parë prej saj.
2. Ministria kompetente i paraqet për shqyrtim Këshillit të Ministrave, brenda 30 ditëve pune nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, propozimin për ratifikimin e marrëveshjes, të shoqëruar nga dokumentet e mëposhtme:
 - a) projektligji për ratifikim;
 - b) projektvendimi për propozimin e projektligjit;
 - c) vendimi i miratimit në parim;
 - ç) tekstet e marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze ose përkthimi i certifikuar, në mungesë të nënshkrimit në gjuhën shqipe;
 - d) relacioni shpjegues, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji;
 - dh) mendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe i Ministrisë së Drejtësisë për përmbajtjen e projektligjit.
3. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për ratifikim Kuvendit “

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim dhe në tërësi, me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI